



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**



PLANI I KONSULTIMEVE PUBLIKE ME QYTETARË PËR VITIN 2025

Duke u bazuar në nenin 20 pika 1, 2, 3 dhe 4, e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Komuna e Podujevës ka përgatitur planin e dokumenteve të cilat do të dalin në konsultim publik me qytetarë, OJQ-të dhe palët tjera relevante.

Plani parasheh njoftimin me kohë të qytetareve, organizatave të shoqërisë civile si dhe organizatave ndërkombëtare për procedurat e hartimit të dokumenteve komunale, vendin dhe kohën e konsultimeve.

Konsultimet publike organizohen nga Zyra për Komunikim me Publikun, zyrtari përgjegjës për konsultime publike, drejtoritë komunale dhe iniciuesit tjerë eventual për hartim të ndonjë dokumenti.

Për secilin konsultim publik do të mbahet procesverbali dhe në përmbyllje të konsultimit hartohet raporti përfundimtar. Procesverbali dhe raporti publikohen në ueb faqe zyrtare si dhe në platformën e konsultimeve publike.

Dokumentet që do të dalin në konsultim publik me qytetarë gjatë vitit 2025:

	Përgjegjës për organizimin e konsultimit	Titulli i Dokumentit	Koha dhe vendi i fillimit të hartimit të dokumentit	Koha e pritshme për të miratim aktit në kuvend	Metodat tjera krahas me platformat online	Buxheti	Procesmbajtës/se Komunikimi me mediat
1.	Zyra e Kryetarit Njësia për Komunikim me Publikun	Rregullore për Transparencë Komunale në Komunën e Podujevës	Janar Salla Kuvendit Komunal	Mars	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës së Podujevës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtorja/njësia e iniciuese Liridona Rrahmani
2.	Zyra e Kryetarit Njësia për Komunikim me Publikun	Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028	Janar Salla Kuvendit Komunal	Mars	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës së Podujevës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtorja/njësia e iniciuese Liridona Rrahmani
3.	Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim Njësia për Komunikim me Publikun	Rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve	Shkurt Salla Kuvendit Komunal	Prill	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës së Podujevës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtorja/njësia e iniciuese Mirlinda Zulfaj
4.	Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit	Taksë administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e	Mars Salla	Maj	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës së Podujevës	Pa kosto	Zyrtari që caktohet nga drejtorja/njësia e iniciuese

	Njësia për Komunikim me Publikun	infrastrukturës	Kuvendit Komunal		Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të		Remzi Kodraliu
5.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa Njësia për Komunikim me Publikun	Qarkorja e parë buxhetore (Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028)	Qershor Salla Kuvendit Komunal	Korrik	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës së Podujevës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari që caktohet nga drejtoria/njësia i iniciuese Liridona Rrahmani
6.	Zyra e Kryetarit- Zyra e Personelit Njësia për Komunikim me Publikun	Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në komunën e Podujevës	Qershor Salla Kuvendit Komunal	Korrik	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës së Podujevës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari që caktohet nga drejtoria/njësia i iniciuese Fitim Bunjaku
7.	Zyra e Kryetarit Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Njësia për Komunikim me Publikun	Plani Zhvillimor Komunal	Korrik Salla Kuvendit Komunal	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës së Podujevës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari që caktohet nga drejtoria/njësia i iniciuese Blerina Zeka
8.	Zyra e Kryetarit Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Njësia për Komunikim me	Forma e vendosjes dhe shfrytëzimit të hapësirës individuale dhe publike për reklama	Korrik Salla Kuvendit Komunal	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës së Podujevës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari që caktohet nga drejtoria/njësia i iniciuese Artiola Zeneli

	Publikun						
9.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa Njësia për Komunikim me Publikun	Qarkorja e dytë buxhetore (Dëgjimet publike për buxhetin e vitit 2026)	Gusht Salla e Kuvendit Komunal	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës së Podujevës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia i iniciuese Liridona Rrahmani

Plani i Konsultimeve Publike për vitin 2025, mund të ndryshoj varësisht nga kërkesat at-hoc që mund të vijnë nga kryetari i komunës, kryesuesja e kuvendit, drejtoritë/ zyrtarë komunale dhe kërkesat që mund të vijnë nga niveli qendror-qeveria, ministritë dhe palët të tjera eventuale.

Në konsultime publike mund të marrin pjesë: Qytetarët, kryetarët/et e këshillave të lagjeve dhe fshatrave, përfaqësuesit e OJQ-ve, përfaqësuesit e komuniteteve, të rinjtë/rejat, pensionistët/et, studentët/et, komuniteti i biznesit, përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike, anëtar/e të Kuvendit Komunal të Podujevës, deputet/e, punonjësit e komunës, përfaqësuesit e partive politike dhe përfaqësuesit e mediave dhe palë të tjera të interesuara.

Përgjegjës për zbatimin e planit janë:

- 1.Kryetari i Komunës,
- 2.Kryesuesi i Kuvendit Komunal,
- 3.Drejtorët e Drejtorive Komunale,
- 4.Njësitë/zyrat.

Dokumenti është i bazuar në planin e punës së kryetarit të komunës, planin e punës së kuvendit të komunës, drejtorive dhe njësive/zyrave tjera që planifikojnë të hartojnë dokumente gjatë vitit 2025.

- Lajmet, njoftimet, thirrjet, ftesat, shpalljet dhe agjendat tjera zyrtare të komunës sonë i publikojmë me kohë dhe sipas kërkesave ligjore në uebfaqe të komunës dhe platformat tjera sociale në shfrytëzim zyrtar. Publikimet i gjeni edhe në linkun vijues: [» Lajmet](#)

Shkurtesat:

SKK-Salla e Kuvendit Komunal

Liridona Rrahmani

Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun

Zyrtare përgjegjëse për Konsultime Publike